



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk.II.nr.1338/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Teuta COS” SH.P.K, me seli në Prizren, kundër debitorit “Swiss Bau” SH.P.K, me seli në Rr. Lagja Arbana, në Prizren, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.181/23 të datës 22.05.2023, me datë **05.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit “Teuta COS” SH.P.K, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.181/23 të datës 22.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.181/23 të datës 22.05.2023 në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit “Swiss Bau SH.P.K”, ka anuluar urdhri përmbarimor P.nr.875/21 i datës 12.07.2021, i Përmbaruesit Privat Enis Hoxha, ashtu që është përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje

Ekonomike, KPPP.nr.181/23 të datës 22.05.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet së cilës ka theksuar se fatura në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbareme për të qenë e përshtatshme për përmbareme duhet të nënshkruhet dhe të vuloget nga personi kompetent për të pranuar faturat andaj nuk qëndrojnë pretendimet e kreditorit se është pranuar nëpërmjet postës sepse e njëjta është kundërshtuar nga debitori dhe nuk mund të konsiderohet si e pranuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbareme si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Teuta COS” SH.P.K, me datën 12.07.2021 ka paraqitur propozimin për përmbareme në bazë të dokumentit – Faturës nr. 10 të datës 29.06.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguajë kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 58,278.42 € (pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë euro e katërdhjetë e dy cent), dhe nëse nuk e kryen detyrimin brenda afatit prej 7 ditësh do t’i llogaritet edhe kamatëvonesa në lartësi prej 8 % vjetore nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbareme.

Përmbaremi Privat Enis Hoxha me seli në Prizren duke vepruar sipas propozimit për përmbareme të kreditorit me urdhrin përmbaremi P.nr.875/21 dt.17.07.2021 e ka lejuar përmbaremin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbaremi duke theksuar se Fatura nr. 10 e datës 29.06.2021 nuk i plotëson tiparet e dokumentit të besueshëm, e kjo vërtetohet nga fakti se kjo faturë e cila nuk është e nënshkruar dhe as e vulosur nga ana e debitorit. Më tej ka shtuar se në situacionin nr. 27/SB-2021, me të cilën i është bashkangjitur propozimit për përmbareme i njëjti është i pa nënshkruar dhe vulosur nga ana e debitorit, ashtu që nënshkrimi tek situacioni i paraqitur nuk është i personi të autorizuar të debitorit. Debitori ka theksuar se faturën e dërguar me postë nga ana e kreditorit, e kemi

kundërshtuar, ngase të gjitha çështjet në mes të palëve lidhur me ndërtimin e objektit afarist dhe çështjet financiare janë përfunduar. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit “Sëiss Bau SH.P.K”, dhe të anulohet në tërësi Urdhri Përmbarimor P.nr.875/21 i datës 12.07.2021 i Përmbaruesit Privat Enis Hoxha.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, ka theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, për arsye se faturat e lartcekura i plotësojnë të gjitha kushtet për t’u konsideruar dokument i besueshëm. Më tej ka shtuar se debitori faturën e lartcekur e ka pranuar nga situata me nr.27/SB-2021, përmes së cilës janë kryer punimet shtesë në objektin afarist sipas aneks kontratës të lidhur me datë 11.08.2019. Kreditori thekson se pretendimet e debitorit janë të pa bazuara dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si prova, por që debitori me parashtrimin e prapësimit dëshiron që të shmanget nga përmëshja e detyrimit dhe të përfitoj në kohë. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr.875/21 i datës 12.07.2021 i Përmbaruesit Privat Enis Hoxha të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që ta paguaj borxhin e cekur si në propozim për përmbarim si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin PPP.nr.201/2021 të datës 28.03.2022, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.875/21 të datës 12.07.2021 dhe të njëjtin e ka lënë në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1231/22 të datës 10.01.2023 ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr.201/2021 të datës 28.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, 3 (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.

04/L-139 Për Procedurën Përmbare, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbare duhet të anulohet dhe procedura përmbare të përfundohet në tërësi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbare nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se Fatura nr. 10 e datës 29.06.2021 edhe pse është pranuar nga debitori përmes postës, e njëjta është kundërshtuar nga ana e debitorit përmes parashtresës së datës 01.07.2021 dhe për këtë kundërshtim është njoftuar kreditori gjë e cila provohet me anë të dëftesës për pranimin e dërgesës nr. 1646846 të datës 01.07.2021.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbare kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbare është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbare po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranohet edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura nr. Fatura nr. 10 e datës 29.06.2021, si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, edhe pse është pranuar nga debitori nëpërmjet postës, e njëjta është kundërshtuar nga debitori nëpërmjet parashtresës së datës

01.07.2021, andaj, në këtë mënyrë fatura e lartcekur meç nuk është nënshkruar dhe pranuar nga debitori nuk mund konsiderohet si dokument i besueshëm.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr.1338/23, me datë 05.03.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami